



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0011522-2/26 dt. 05.03.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenet 7, 38 dhe 39 të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve si dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0011522/26, dt. 04.03.2026 të Drejtorisë për Shëndetësi, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Ndarjen e Subvencioneve për Personat Fizik nga Drejtoria për Shëndetësi pa Thirrje Publike)

1. **Formohet** Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Ndarjen e Subvencioneve për Personat Fizik nga Drejtoria për Shëndetësi pa Thirrje Publike, në këtë përbërje:
 - 1.1 Dr. Sami Kurti – kryetar (QKMF);
 - 1.2 Arbenita Mustafa Januzi – anëtare (DSH);
 - 1.3 Berat Jashari – anëtar (DSH);
 - 1.4 Diar Haziri – anëtar (QPS);
 - 1.5 Albana Fejza – anëtare (DSH).
2. Komisioni është përgjegjës që të shqyrtojë të gjitha kërkesat e paraqitura për përkrahje financiare nga personat fizik që aplikojnë për subvencionim në kuadër të kësaj Drejtorie në përputhje me kriteret e përcaktuara me Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe Planin e Punës së Drejtorisë.
3. Komisioni i lartcekur obligohet që të shqyrtojë kërkesat në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës, dhe pas shqyrtimit të kërkesave obligohet që të përgatitë Rekomandim, e të njëjtin t’ia prezantojë Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi, i cili duke u bazuar në Raport-Rekomandimin e Komisionit, nxjerrë Propozim-Vendim për Kryetarin e Komunës me qëllim të Vendim marrjes në lidhje me kërkesat.
4. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Ligjin Nr. 05/L-



031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat 1 (një) vit.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Edon PEÇI

Shtojcë:

Propozim-Vendimi Nr. 01-020/04-0011522/26, dt. 04.03.2026 i Drejtorisë për Shëndetësi.

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Shëndetësi
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit

